



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.905/2 prot.,

Datë 16.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur”, me REF-97645-03-07-2024 me objekt “Zgjerimi i sistemit AV”, me fond limit me vlerë 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Ankimues: Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK me Nipt. M31904013D me adres Tirane, Rruga e Dibres, Njesia administrative Nr 8 Tirane, Vila nr.153, Kati i Pare zona kadastrale nr 8360.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).
Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/3967, datë 15.04.2024 dhe me Nr.905/2024 Prot., datë 15.04.2024 e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me REF-97645-03-07-2024 me objekt “Zgjerimi i sistemit AV”, me fond limit me vlerë 15,480,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose

enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, për arsye se të gjithë faturat e paraqitura për të përmbushur kushtin e kontratave të ngjashme nuk kanë lidhje/ngjashmëri me objektin e kësaj procedure prokurimi. Asnjë nga këto fatura të paraqitura nuk kanë në objekt të vetë zgjidhje antivirus, edr apo xdr.

Faturat e ngjashme kanë si objekt shitjen e pajisjeve si Fireëall, Licenca microsoft ëindoës, Softëare për regjistrimin e video-audio, Softëare i menaxhimit te datave, Platforme komunikimi e pajisjeve komunikuese, server, etj.

Gjithashtu, zgjidhja teknike e ofruar nuk është në përputhje me kërkersat dhe specifikimet teknike të kësaj procedure prokurimi. Bazuar në specifikimet teknike është kërkuar që: “Zgjidhja e kërkuar duhet të lejojë instalimin/konfigurim e saj në cloud dhe on-prem si dhe integrimin e plotë me sistemin aktual të antivirus.”

Sistemi antivirus i instaluar pranë AK është Checkpoint ndërkohë zgjidhja e ofruar është Trellix e cila në asnjë paragraf të datasheet nuk shprehet që është e aftë të integrohet me sistemin aktual të antivirus. Zgjidhja XDR referuar specifikimeve teknike të ofruara nga OE, sipas specifikimeve teknike të ofruara nuk është e integrueshme plotësisht (vetëm shkëmben të dhëna për sa i përket log-eve). Kjo sjell që sistemi i cili kërkohet të prokurohet mos të ketë mundësinë të ndërveprojë apo të manaxhoj sistemin antivirus dhe agjentët që AK ka të instaluar aktualisht në të gjitha pajisjet.

Zgjidhja e kërkuar nga AK duhet të jetë XDR dhe XPR, pra një sistem i zgjeruar i Detektimit dhe Përgjigjes (XDR) dhe të Parandalimit dhe Përgjigjes së Zgjeruar XPR, me qëllim krijimin e aftësive të avancuara jo vetëm të detektimit por dhe marrjen e masave proaktive të parandalimit nga kërcënimet kibernetike.

Referuar specifikimeve teknike sipas datasheet që operatori ekonomik ka paraqitur rezulton që zgjerimi me XPR (Extended Prevention & Response) të mos jetë i përfshirë. Operatori ekonomik ka ofruar në këtë procedurë prokurimi specifikimet teknike të cilat rezultojnë të jenë vetëm për XDR.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.04.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri